



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

NDËRTIM

Niveli IV në KSHK¹, referuar nivelit IV të KEK²

B-IV-23

Tiranë 2023

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimit

Emërtimi i kualifikimit	NDËRTIM			Kodi B-IV-23
	Kohëzgjatja	Niveli	IV KSHK, referuar nivelit IV të KEK	
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Ndërtim” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK është të përgatisë teknik/menaxher të mesëm në fushën e ndërtimit të objekteve ndërtimore dhe infrastrukturës inxhinierike, për t’u punësuar në institucione të ndryshme shtetërore, shoqëri ndërtuese, si teknik ndërtimi për menaxhimin e veprimtarive të ndryshme ndërtuese apo për krijimin e menaxhimin e një biznesi privat ndërtimi, si person fizik ose juridik.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në kualifikimin “Ndërtim” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK kanë të drejtë të hyjnë të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kanë mbaruar arsimin profesional në një kualifikim të niveli III të KSHK-së, referuar nivelit III të KEK ; • janë në kushte shëndetësore që përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional; • <u>kanë aftësi ndryshe</u>, por për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë që shfaqin. <p>Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, institucionet përgjegjëse përgatitin udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.</p>			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<ul style="list-style-type: none"> – Përfundimi me sukses i arsimit profesional në kualifikimin “Ndërtim” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe suplementin përkatës të përfundimit të këtij niveli si teknik/menaxher i mesëm në këtë kualifikim, të cilat njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë. – Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në institucione të ndryshme shtetërore dhe shoqëri ndërtuese që ushtrojnë aktivitet të profilit ndërtimor. Individu mund të punësohet dhe vetëpunësohet si teknik/menaxher i mesëm ndërtimi në kuadrin e një biznesi individual në fushën e ndërtimit, në profesionet si: karpentieri, hekurkthim dhe betonim, muratim-suvatim, shtrim dhe veshje me pllaka, punime dhe riparim rrugësh (përfshirë punime të infrastrukturës inxhinierike), punime dekorative dhe bojatisje, mirëmbajtje ndërtesash. Gjithashtu mund të punësohet dhe vetëpunësohet në njësi të tregimit të materialeve të ndërtimit. – Me përfundimin e këtij niveli, individit ka mundësi për të fituar të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” dhe mundësinë për vazhdimin e arsimit në nivelin pas të mesëm ose në nivelin e studimeve universitare. 			
Data e validimit	Korrik 2023			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	B-III-15; B-IV-19;			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional “Ndërtim” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale si më poshtë:

Planifikimi dhe organizimi i punës

- Të përshkruajë mënyrën e organizimit të punës për drejtimin e grupeve të veçanta në varësi të procesit të punës (ose të grupeve në tërësi);
- Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes së burimeve njerëzore për realizimin e proceseve të ndryshme;
- Të shpjegojë rëndësinë e organizimit të vendit të punës në mënyrë ergonomike;
- Të shpjegojë mënyrën e ndarjes së detyrave në ekip;
- Të shpjegojë mënyrën dhe rëndësinë e kontrollit të pastrimit dhe sistemit të vendit të punës;
- Të shpjegojë mënyrën dhe rëndësinë e kontrollit të procedurave për ngritjen e kantierit;
- Të shpjegojë rëndësinë e sigurimit të burimeve të nevojshme (ujë, energji elektrike etj.);
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes së rezervës së nevojshme për materiale (lëndë të para, ndihmëse, vegla pune, pajisje etj.), për ecurinë e proceseve të punës;
- Të shpjegojë projekt zbatimin (fletët arkitektonike dhe konstruktive);
- Të listojë materialet e domosdoshme për realizimin e procesit të punës në objektet e ndërtimit;
- Të listojë llojet e punimeve dhe radhën e realizimit të tyre për një objekt ndërtimi;
- Të listojë mjetet dhe makineritë që përdoren për realizimin e procesit të punës në objektet e ndërtimit;
- Të rendisë dokumentacionin teknik për dorëzimin e një objekti ndërtimi sipas legjislacionit në fuqi;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe format e raportimit të punës së kryer te eprorët;
- Të shpjegojë mënyrën e hartimit të grafikut të punimeve;
- Të përshkruajë plan-organizimin e kantierit të ndërtimit të miratuar nga institucioni përkatës vendor (si pjesë e dokumentacionit të përgjithshëm në momentin e miratimit të lejes së zhvillimit);

Dokumentacioni teknik

- Të interpretojë vizatimin teknik të elementeve të ndryshme ndërtimore, përmasat dhe karakteristikat e materialeve të lidhura me to, tolerancat e lejuara, kushtet teknike etj.;
- Të përshkruajë mënyrën e formulimit të propozimeve dhe argumentimin e tyre, lidhur me projektin në njësinë përkatëse apo në marrëdhëniet me klientin;
- Të përshkruajë përdorimet e programeve kompjuterike si EXCEL (për preventiva/situacione) dhe AutoCAD ose të ngjashme (për projekte/vizatime ndërtimore).
- Të përshkruajë rëndësinë e hartimit të raporteve ditore të teknikut;
- Të shpjegojë mënyrën e përgatitjes së të dhënave mbi ecurinë ditore të punimeve;
- Të shpjegojë mënyrën e hartimit të dokumentacionit të punimeve të kryera;

- Të shpjegojë rëndësinë e instruktimit teknik të punëtorëve;
- Të shpjegojë rëndësinë e mbajtjes së listëprezencës të punëtorëve dhe specialistëve;

Zbatimi i projektit dhe mirëmbajtja

- Të japë shembuj të bashkëpunimit me topografin për piketimin dhe kuotat;
- Të shpjegojë mënyrën e kontrollit për gërmimet dhe transportin e dherave;
- Të shpjegojë mënyrën e kontrollit për vendosjen e hekurit dhe ndërtimin e kallëpeve në elementët betonarme;
- Të shpjegojë mënyrën e kontrollit të proceseve të betonimit, për çdo element betonarme;
- Të shpjegojë mënyrën e kontrollit për punimet e muratimit dhe suvatimit;
- Të shpjegojë mënyrën e kontrollit për punimet hidroizolimi;
- Të shpjegojë mënyrën e kontrollit për punimet e shtrimit të pllakave dhe veshje muresh;
- Të shpjegojë mënyrën e kontrollit për punimet dekorative dhe bojatisje;
- Të shpjegojë mënyrën e kontrollit për punimet në rrugë dhe trotuare;
- Të shpjegojë mënyrën e kontrollit për punime me teknikët e disiplinave të tjera;
- Të shpjegojë mënyrën e largimit të materialeve të papërdorshme;
- Të japë shembuj të kontrollit për proceset e riparimit dhe mirëmbajtjes së punimeve;
- Të listojë defektet e thjeshta dhe parregullsitë në kryerjen e punimeve të ndërtimit, duke gjykuar për shkaqet e tyre;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrën e riparimit të defekteve të thjeshta dhe parregullsive në kryerjen e punimeve të ndërtimit (sipas projektit të riparimit);
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e hartimit të një plani mirëmbajtjeje për punime të thjeshta të ndërtimit duke parashikuar koston e tyre.

Sigurimi i cilësisë së punimeve

- Të përshkruajë mënyrën e verifikimit të cilësisë të punimeve për ngritjen e kantierit;
- Të përshkruajë mënyrën e verifikimit të punimeve të skarifikimit dhe nivelimit të terrenit sipas planvendosjes së objektit;
- Të përshkruajë mënyrën e verifikimit të punimeve të piketimit sipas projekt zbatimit;
- Të përshkruajë mënyrën e verifikimit të punimeve të modinimit, gërmimit dhe bazamentit sipas kushteve teknike të projekt zbatimit;
- Të përshkruajë mënyrën e verifikimit të fiksimit/shënimit të kuotave respektive sipas projekt zbatimit;
- Të përshkruajë mënyrën e verifikimit të cilësisë në punimet e zbatimit të kuotave respektive sipas kushteve teknike të projekt zbatimit;
- Të përshkruajë rëndësinë e kontrollit të përputhshmërisë së materialeve gjatë zbatimit të punimeve sipas Standardeve;
- Të përshkruajë rëndësinë e marrjes së mostrave në kohën e duhur për testim të materialeve;
- Të përshkruajë mënyrën e verifikimit të cilësisë së punimeve të konstruksionit mbajtës sipas kushteve teknike të projekt zbatimit;
- Të përshkruajë mënyrën e verifikimit të cilësisë së punimeve të muratimit dhe suvatimit sipas kushteve teknike të projekt zbatimit;
- Të përshkruajë mënyrën e verifikimit të cilësisë së punimeve të hidroizolimit;
- Të përshkruajë mënyrën e verifikimit të cilësisë së punimeve për shtrim pllakash dhe veshje

- muresh sipas kushteve teknike të projekt zbatimit;
- Të përshkruajë mënyrën e verifikimit të cilësisë së punimeve dekorative dhe bojatisje sipas kushteve teknike të projekt zbatimit;
- Të përshkruajë mënyrën e kontrollit të cilësisë së punimeve në rrugë dhe trotuare sipas kushteve teknike të projekt zbatimit;
- Të përshkruajë mënyrën e kontrollit të cilësisë në proceset e punimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes sipas kushteve teknike të projekt zbatimit;

Llogaritje të-volumeve, kostove dhe çmimeve

- Të përshkruajë sasisë e materialeve sipas skedës teknike dhe mënyrat e llogaritjes së tyre;
- Të përshkruajë konceptin e normimit të punimeve shtesë;
- Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes së çmimeve të materialeve kryesore dhe ndihmëse;
- Të përshkruajë sasisë e konsumit të karburantit të mjeteve, ujit dhe energjisë elektrike dhe mënyrat e llogaritjes së tyre;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes së kostove të personelit mbështetës dhe të shërbimit;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes së kostos së shfrytëzimit të makinerive, mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të përshkruajë rëndësinë e llogaritjes së shpenzimeve për provat laboratorike;
- Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes së koston së materialeve dhe shërbimeve/punimeve të kryera;
- Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes së çmimit përfundimtar për punimet/shërbimet e ofruara;

Sipërmarrje dhe menaxhim biznesi

- Të listojë llojet e dokumenteve që përdorën në fushën e ndërtimit;
- Të shpjegojë parimet bazë të kodit të punës;
- Të përshkruajë legjislacionin bazë të fushës së ndërtimit;
- Të përshkruajë format dhe mënyrat e hartimit të dokumentacionit teknik;
- Të përshkruajë mënyrën e arkivimit të dokumentacionit teknik;
- Të përshkruajë mënyrën e regjistrimit të të dhënave për faturat dhe përgatitjes së një oferte;
- Të listojë llojet e raportimeve;
- Të shpjegojë mënyrën e kontrollit të çmimeve të tregut të materialeve bazuar në standardet e ndërtimit;
- Të listojë elementët e llogaritjes së kostos materialeve dhe çmimit të një shërbimi;
- Të listojë llojet e faturave dhe mënyrën e plotësimit të tyre;
- Të listojë mënyrat e sigurimit të materialeve, mjeteve dhe pajisjeve të ndryshme;
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së dokumenteve për dorëzimin e punimeve në ndërtim;
- Të listojë teknikat e ndryshme të marketingut;
- Të analizojë interesat, zotësitë dhe aftësitë personale përmes mënyrave të ndryshme përfshirë vetëvlerësimin;
- Të analizojë format e ndryshme të sipërmarrjes në lidhje me synimet kryesore të karrierës personale, mundësitë dhe përfitimet në komunitet;
- Të përshkruajë teknologjitë bashkëkohore për proceset e punës në specialitetin “Teknik i

mesëm ndërtimi”;

- Të listojë mënyrat e transmetimit në kohë tek bashkëpunëtorët për njohuritë dhe aplikimin e teknikave të reja në punë;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e përdorimit të literaturës bashkëkohore;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e pjesëmarrjes në panairë dhe ekspozita;
- Të listojë llojet e trajnimeve dhe kurseve teknike.

Komunikimi etik dhe profesional

- Të identifikojë metodat e informacionit për problemet dhe të rejat e ditës;
- Të shpjegojë parimet kryesore të punës në grup;
- Të listojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të shpjegojë parimet bazë të kodit të etikës në punë;
- Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit në mënyrë etike dhe profesionale me kolegët dhe eprorët;
- Të listojë metodat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimit kritik;
- Të përshkruajë rolin e bashkëpunëtorëve në veprimtarinë profesionale;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë së informimit dhe komunikimit, për të bërë të mundur sigurimin e informacionit nga të gjitha burimet e mundshme, si interneti, shtypi, revistat, librat, reklamat, botimet e karakterit periodik teknik etj.;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të saktë të terminologjisë teknike dhe profesionale gjatë punimeve të ndërtimit;
- Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.;
- Të përshkruajë rëndësinë e koordinimit dhe rregullat e komunikimit me teknikët e operatorët e tjerë.

Rregullat e sigurimit teknik, të ruajtjes së shëndetit në punë dhe mbrojtjes së mjedisit

- Të përshkruajë rëndësinë e standardeve dhe legjislacionit shqiptar për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së shëndetit në punë;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të standardeve ndërkombëtare;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e përdorimit të manualeve të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të sinjalistikës në mjedisin e punës;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të procedurave për evakuim në raste emergjence;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të pajisjeve të mbrojtjes dhe shpëtimit ndaj zjarrit;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të llojeve të mjeteve dhe veprimet e nevojshme që duhen për ndihmën e parë;
- Të përshkruajë rëndësinë e ndarjes së proceseve specifike të punës sipas aftësive të punonjësve;
- Të përshkruajë rreziqet kryesore të ndotjes së mjedisit nga; shkarkimet e gazrave të dëmshëm në ajër, shkarkimet e lëngjeve e të ujërave të ndotura (infektuara) në mjedise të hapura, të lëndëve të ngurta jomiqësore me mjedisin etj.;

- Të përshkruajë masat që duhen marrë dhe pajisjet e nevojshme për të bërë neutralizimin e efekteve të dëmshme të gazrave, të ujërave të ndotura dhe të mbetjeve të ngurta që janë jomiqësore me mjedisin etj.;
- Të shpjegojë rëndësinë e instruktimit të punonjësve për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik sipas proceseve të punimeve të ndërtimit;
- Të shpjegojë rëndësinë kontrollit të përdorimit të pajisjeve të mbrojtjes personale dhe kolektive në punë, në përputhje me manualet dhe udhëzimet përkatëse;
- Të përshkruajë rëndësinë e rregullores për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të tabelave të sigurimit teknik në kantier;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të protokolleve të duhura në raste pandemie;
- Të përshkruajë rëndësinë e bashkëpunimit për vlerësimin e rrezikut dhe për eliminimin e tij;

Rezultatet e të nxënit në:

SHPREHI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional “Ndërtim” niveli IV në KSHK, individi do të jetë i aftë:

Planifikimi dhe organizimi i punës

- Të organizojë punën për drejtimin e grupeve të veçanta në varësi të procesit të punës që ato kryejnë (ose të grupeve në tërësi),
- Të kryejë llogaritjen dhe menaxhimin e burimeve njerëzore për realizimin e proceseve të ndryshme;
- Të organizojë kryerjen e proceseve të punimit të ndërtimit, deri në përfundimin e tij;
- Të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike;
- Të ndajë detyrat në ekip;
- Të kontrollojë sistemimin dhe pastrimin e vendit të punës;
- Të kontrollojë procedurat e ngritjes e kantierit;
- Të sigurojë burimet e nevojshme për realizimin e proceseve të punës (ujë, energji elektrike etj.);
- Të përcaktojë rezervën e nevojshme materiale (lëndë të para, ndihmëse, vegla pune dhe pajisje etj.), për ecurinë e proceseve të punës;
- Të zërthejë fletët arkitektonike dhe konstruktive të projektit të zbatimit;
- Të llogaritë materialet dhe pajisjet e domosdoshme për realizimin e procesit të punës në objekt ndërtimi bazuar në skicën apo projektin e dhënë;
- Të përcaktojë llojet e punimeve dhe radhën e realizimit të tyre për një objekt ndërtimi;
- Të hartojë listën e mjeteve dhe makinerive që përdoren, dokumentet e magazinimit, të furnizimit apo shpërndarjes së materialeve në kantier etj.;
- Të përzgjedhë mjetet, makineritë, pajisjet e punës dhe materialeve në kantier sipas proceseve të punës;
- Të raportojë te eprorët për punën e kryer;
- Të hartojë grafikun e punimeve;

- Të zbatojë plan-organizimin e kantierit të ndërtimit, skemat e furnizimit të energjisë, ujit e telekomunikacionit;

Dokumentacioni teknik

- Të zbërthejë vizatimin teknik të elementeve të ndryshme ndërtimore, përmasat dhe karakteristikat e materialeve të lidhura me to, tolerancat e lejuara, kushtet teknike etj.;
- Të formulojë propozime dhe t'i argumentojë ato, lidhur me projektin në njësinë përkatëse apo në marrëdhëniet me klientin;
- Të përdorë programet kompjuterike si EXCEL (për preventiva/situacione) dhe AutoCAD ose programe të ngjashme (për projekte/vizatime ndërtimore).
- Të ndihmojë në hartimin e raporteve të teknikut të ndërtimit
- Të përpilojë të dhënat mbi ecurinë ditore të punimeve;
- Të ndihmojë në hartimin e dokumentacionit të punimeve të kryera;
- Të ndihmojë/mbajë listëprezencën e punëtorëve dhe specialistëve apo /edhe të stafit mbështetës në kantier.

Zbatimi i projektit dhe mirëmbajtja

- Të bashkëpunojë me topografin për piketimin dhe kuotat;
- Të kontrollojë kuotat dhe piketimet për gërmimet dhe transportin e dherave, si dhe zbatimin e procedurave për realizimin e tyre;
- Të kontrollojë vendosjen e hekurit dhe ndërtimin e kallëpeve në elementet betonarme, si dhe zbatimin e procedurave për realizimin e tyre;
- Të monitorojë hedhjen e betonit në çdo element beton arme, si dhe trajtimin e betonit pas ngurtësimit;
- Të mbikëqyrë punimet e muratimit dhe suvatimit;
- Të kontrollojë punime të hidroizolimit;
- Të kontrollojë punimet për shtrim pllakash dhe veshje muresh;
- Të kontrollojë punimet dekorative dhe bojatisjes;
- Të ndjekë punimet në rrugë dhe trotuare;
- Të marrë pjesë në kontrollin e punimeve, me teknikë të disiplinave të tjera;
- Të monitorojë largimin e materialeve të papërdorshme;
- Të kontrollojë proceset e riparimit dhe mirëmbajtjes së punimeve;
- Të analizojë defektet e thjeshta dhe parregullsitë në kryerjen e punimeve të ndërtimit për objektin e ndërtimit, duke gjykuar për shkaqet e tyre;
- Të aplikojë procedurat dhe mënyrën e riparimit të defekteve të thjeshta dhe parregullsive në kryerjen e punimeve të ndërtimit (sipas projektit të riparimit);
- Të ndihmojë në hartimin e një plani mirëmbajtjeje për punime të ndryshme të ndërtimit duke parashikuar koston e tyre.

Sigurimi i cilësisë së punimeve

- Të kryejë zbatimin e planit të organizimit të punimeve në kantierin e punës sipas projektit;
- Të verifikojë punimet e skarifikimit dhe nivelimit të terrenit sipas planvendosjes së objektit;
- Të verifikojë punimet e piketimit sipas projekt zbatimit;
- Të verifikojë punimet e modinimit, gërmimit dhe bazamentit sipas kushteve teknike të projektit

- zbatimit;
- Të verifikojë punimet e fiksimit/shënimit të kuotave respektive sipas projekt zbatimit;
 - Të verifikojë cilësinë e punimeve të zbatimit të kuotave respektive sipas kushteve teknike të projekt zbatimit;
 - Të verifikojë kontrollin e përputhshmërisë së materialeve të punimeve sipas Standardeve;
 - Të kryejë marrjen e monstrave në kohën e duhur për testim të materialeve;
 - Të verifikojë cilësinë e punimeve të konstruksionit mbajtës sipas kushteve teknike të projekt zbatimit;
 - Të verifikojë cilësinë e punimeve të muratimit dhe suvatimit sipas kushteve teknike të projekt zbatimit;
 - Të verifikojë cilësinë e punimeve të hidroizolimit;
 - Të verifikojë cilësinë e punimeve për shtrim pllakash dhe veshje muresh sipas kushteve teknike të projekt zbatimit;
 - Të verifikojë cilësinë e punimeve dekorative dhe bojatisje sipas kushteve teknike të projekt zbatimit;
 - Të verifikojë cilësinë e punimeve në rrugë dhe trotuare sipas kushteve teknike të projekt zbatimit;
 - Të verifikojë cilësinë e punimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes së objektit sipas kushteve teknike të projekt zbatimit;

Llogaritje të volumeve, kostove dhe çmimeve

- Të llogarisë sasinë e konsumit të materialeve sipas skedës teknike;
- Të llogarisë volumet e punimeve shtesë;
- Të verifikojë çmimet e materialeve kryesore dhe ndihmëse;
- Të llogarisë sasinë e konsumit të karburantit të mjeteve, ujit dhe energjisë sipas normativave;
- Të llogarisë koston e personelit mbështetës dhe të shërbimit sipas normativave;
- Të llogarisë koston e shfrytëzimit të makinerive, mjeteve dhe pajisjeve të punës sipas normativave ;
- Të bashkëpunojë në llogaritjen e koston të shpenzimeve për provat laboratorike;
- Të llogarisë koston e materialeve dhe shërbimit/punimit të kryer;
- Të llogarisë çmimin përfundimtar për punimet/shërbimet e ofruara;

Sipërmarrje dhe menaxhim biznesi

- Të zbatojë legjislacionin tatimor, kodin e punës dhe legjislacionin në fushën e lidhur me aktivitetin që kryen;
- Të plotësojë plane ditore, javore, mujore të punës, në përputhje me detyrat;
- Të arkivojë dokumentacionin teknik në ndërtim;
- Të regjistrojë të dhënat e faturave dhe përgatitjes së një oferte;
- Të kontrollojë çmimet e tregut të materialeve bazuar në standardet e ndërtimit;
- Të kryejë blerje të materialeve, mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme ;
- Të përgatisë dokumentet për dorëzimin e punimeve në ndërtim;
- Të plotësojë procesverbalin/dokumentin e dorëzimit të punimeve te klienti;
- Të demonstrojë aftësi për të zhvilluar një projekt-ide sipërmarrëse (për të zhvilluar dhe zbatuar një buxhet të caktuar);

- Të aplikojë parimet e ekonomisë së lirë të tregut në situata të ndryshme;
- Të përdorë teknikat e ndryshme të marketingut;
- Të përdorë teknologjitë bashkëkohore për proceset e punës në specialitetin “Teknik i mesëm ndërtimi”;
- Të transmetojë në kohë tek bashkëpunëtorët njohuritë dhe aplikimin e teknikave të reja në punë;
- Të përdorë literaturën bashkëkohore;
- Të marrë pjesë në panairë dhe ekspozita, trajnime dhe kurse teknike.

Komunikimi etik dhe profesional

- Të marrë informacion për problemet dhe të rejat e ditës;
- Të zbatojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal dhe të punës në grup;
- Të zbatojë parimet bazë të kodit të etikës në punë;
- Të komunikojë në mënyrë etike dhe profesionale me kolegët dhe eprorët;
- Të japë dhe marrë udhëzime nga bashkëpunëtorët për realizimin e detyrës;
- Të përdorë teknologjinë e informimit dhe komunikimit, për të bërë të mundur sigurimin e informacionit nga të gjitha burimet e mundshme, si interneti, shtypi, revistat, librat, reklammat, botimet e karakterit periodik teknik etj.;
- Të përdorë terminologji teknike dhe profesionale gjatë punimeve të ndërtimit;
- Të veprojë në përputhje me parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikim.

Rregullat e sigurimit teknik, ruajtjes së shëndetit në punë dhe mbrojtjes së mjedisit

- Të zbatojë standardet dhe legjislacionin shqiptar për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së shëndetit;
- Të zbatojë standardet e kërkuara ndërkombëtare;
- Të hartojë Planin Operativ të Sigurisë, mbi mundësitë e ndodhjes së rreziqeve në kantier;
- Të zbatojë manualët e përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të respektojë sinjalistikën në mjedisin e punës;
- Të zbatojë planin e evakuimit në raste emergjence;
- Të demonstrojë përdorimin e pajisjeve të mbrojtjes dhe shpëtimit ndaj zjarrit;
- Të demonstrojë veprimet e nevojshme për ndihmën e parë sipas procedurës përkatëse;
- Të sigurohet që aftësitë e punonjësit janë në përputhje me kërkesat e proceseve specifike të punës;
- Të zbatojë rregulloren përkatëse për mos ndotjen e mjedisit nga; shkarkimet e gazrave të dëmshëm në ajër, shkarkimet e lëngjeve e të ujërave të ndotura (infektuara) në mjedise të hapura, të lëndëve të ngurta jomiqësore me mjedisin etj.;
- Të instruktojë punonjësit për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik sipas proceseve të punimeve të ndërtimit;
- Të kontrollojë ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit në përputhje me udhëzimet përkatëse;
- Të kryejë instruktimin teknik ditor të punëtorëve;

- Të kontrollojë përdorimin e pajisjeve të mbrojtjes personale dhe kolektive në punë, në përputhje me manualët dhe udhëzimet përkatëse;
- Të kontrollojë vendosjen e tabelave të sigurimit teknik në kantier;
- Të zbatojë protokollin e duhura në raste pandemie;
- Të kryejë bashkëpunimin për vlerësimin e rrezikut dhe për eliminimin e tij;

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij/saj personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij/saj;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënies të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kriteret e drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij/saj;
- Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
- Të marrë nisma për të bashkëpunuar më individë apo grupe;
- Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
- Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
- Të demonstrojë përgjegjshmëri ndaj mjedisit dhe të mirave publike;
- Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
- Të demonstrojë marrjen e nismave për të zhvilluar dhe zbatuar një ide;
- Të demonstrojë zotësi për të nxënë nga dështimet dhe për të këmbëngulur drejt arritjes së synimeve të tij/saj;
- Të aplikojë mënyra konstruktive të përgjigjeve ndaj kritikave.